



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE PROCEDURALE LIGJORE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

Nr. 768/1 Prot

Tiranë, më 30 08.2016

Drejtuar: **Znj. Eglantina GJERMENI**
MINISTËR
Ministria e Zhvillimit Urban

Lënda: **Mendime për projektligjin “Për programet sociale të strehimit”**

TIRANË

E nderuar znj. Ministre,

Në vijim të shkresës Tuaj Nr. 4330 Prot, datë 01.08.2016, me anë të së cilës dërgohet për mendim *projektligji “Për programet sociale të strehimit”*, vërejmë se është parë nën këndvështrimin e ligjit 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, duke reflektuar komentet tona për zbatimin e parimit të mosdiskriminimit, neni 8 i projektligjit “Për programet sociale të strehimit”.

Duke analizuar projektligjin me kujdes, jemi të mendimit se në nenin 33, pika 5 dhe nenit 42, pika 1, në kategoritë që kanë përparësi në përfitimin e subvencionit të qirasë, duhet të përfshihet edhe kategoria *“të moshuar”*.

Në referencë të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 3, pika 1: *“Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi*, mospërfshirja e kësaj kategori, i vendos ata në pozita të trajtimit diskriminues krahasuar me kategoritë e tjera të përfshira në projektligj.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin,

Miratoi: **A. HALA**

Konceptoi: **M. Rrumbullaku**



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al